



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC**

**SHPALLJE PËR VENDE TË LIRA PUNE
Policia Bashkiake
Pogradec**

**PUNONJËS NË POLICINË E BASHKISË SË POGRADECIT
(POLICË)**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 64 “Kompetencat dhe detyrat e Kryetarit të Bashkisë”, gërma “g”, “Emëron dhe shkarkon punonjësit e tjerë të strukturave dhe njësive në varësi të Bashkisë, përveç kur parashikohet ndryshe në ligjin për nëpunësin civil”, të nenit 5 të ligjit nr. 8224, datë 15.5.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë së Bashkisë dhe Komunës”(i ndryshuar), neni 11 të Rregullores së brendshme “Tip” të policisë së bashkisë dhe komunës, VKM nr. 313 datë 01.07.2002 “ Për caktimin e strukturës së numrit të punonjësve dhe shpenzimeve buxhetore të Policisë së Bashkisë dhe Komunës“

Bashkia e Pogradecit shpall procedurat e konkurimit për 3 (Tre) vende te lira :

Punonjës i Policisë Bashkiake, pranë Bashkisë Pogradec

Kandidatët për polic duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të jetë i moshes 19-27 vjec
- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të kenë të kryer arsimin e mesëm;
- Preferohet të ketë punuar në policinë e shtetit dhe të mos ketë qënë i dënuar për shkelje të rënda dhe vepra penale;
- Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht e mendërisht për të vepruar;
- Të ketë cilësi të larta morale e qytetare;
- Të mos jetë i dënuar nga organet gjyqësore dhe të drejtësisë me vendim të formës së prerë;

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- 1- Kërkesë për aplikim (me shkrim dore);
- 2- Curriculum Vitae
- 3- Fotokopje e Kartës së Identitetit;
- 4- Çertifikatë e përbërjes familjare;
- 5- Fotokopje e diplomës së shkollës dhe lista e notave e noterizuar;
- 6- Çertifikata kualifikimi të ndryshme (në rast se ka);
- 7- Raport mjeko-ligjor ;
- 8- Vërtetim i gjendjes Gjyqësore; ose

- 8.1- Vërtetim nga prokuroria (që nuk është aktualisht në proces hetimi)
8.2-Vërtetim nga Gjykata (që nuk është aktualisht në proces gjyqësor)

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë ose pranë Zyrës së informacionit dhe ankesave të banorëve në Bashkinë e Pogradec brenda datës **17.04.2017**.

REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK TË DOKUMENTACIONIT

Njësia e Burimeve Njerëzore në Bashkinë e Pogradecit do të shpallë në stenden e informimit të publikut dhe në faqen zyrtare të bashkisë Pogradec, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet testimi.

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a-** Njohuritë mbi legjislacionin për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore;
- b-** Njohuritë mbi ligjin nr. 8224, datë 15.5.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë së Bashkisë dhe Komunës” (i ndryshuar);
- c-** Njohuritë mbi Rregulloren e Brendshme “Tip” të policisë së bashkisë dhe komunës.

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën.

Kandidatët në testimin me shkrim dhe gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a-** Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me punën;
- b-** Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c-** Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Bashkinë e Pogradecit do të shpallë fituesit në stendat e informimit të publikut.

Eduart KAPRI
KRYETAR
